



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë: 06.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 04.01.2025, të parashtruar nga OE AMAZON HOLDING SHPK, Rr. RR.PASHKO VASA, 10000 Prishtinë” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor - RITENDERIM.”, me Nr. të Prok: 613-24-13533-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

I Aprovohet Pjesërisht Kërkesa për Rishqyrtim të parashtruar nga OE AMAZON HOLDING SHPK, Rr. RR.PASHKO VASA, 10000 Prishtinë” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor - RITENDERIM.”, me Nr. të Prok: 613-24-13533-2-2-1.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të qartësoj edhe më shumë DT, për aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, ka pranuar kërkesë për Ri-Shqyrtim nga **nga OE AMAZON HOLDING SHPK, Rr. RR.PASHKO VASA, 10000 Prishtinë** me këto pretendime:

Citoj Kërkesat si më poshtë:

Kerkesa 1. Ju keni kerkuar Mbikqyrje dhe funksionimi i parkingut per 24/7, Si mund te behet funksionimi i parkingut per 24 ore, si e keni menduar kur punet e kontraktorit te cilet e ka ekzekutuar nuk jane perfunduar ende, A eshte e llogaritur ne paramase ne rast se parkingu mbetet jofunksionale pershkak te punimeve te instalimeve te cilat jane duke u zhvilluar, te marrim persiper ne si kontraktues te kesaj kontrate. Tani punimet per instalime te cilat jane duke u zhvilluar parkingu mund te mbetet jofunksionale per 3-4 dite, atehere te na tregoni se si keni menduar qe ne te funksionalizojme. Te na tregoni ne paramase per ditet e zhvillimit te punimeve ? 2. Kerkesa 2. Pastrami i parkingut ne cdo ditë Ju ne paramase nuk keni specifikuar se cka duhet te pastrohet per cdo dite. A duhet te mbetet pastrimi me uje i parkingut, ne rast se duhet te behet me uje pastrimi i parkingut, sa here mbrenda dites duhet te pastrohet, se perveq dyschemes se parkingut a duhet te pastrohet muret, shtyllat, shkallet, pjesa hyrese me makina ? A duhet te mbetet pastrimi i mbeturinave me parking, dhe sa here ne dite te behet pastrimi i mbeturinave? Sa here mbrenda nje dite duhet te behet pastrimi i mbeturinave ? Te tregohet ne paramasa sa metra katrore i posedon parkingu, ne menyre qe qmimi te vendoset ne baze te m2 per cdo pozicion te parkingut. Ne gjendjen faktike pllaka e siperme posedon zbrazetira te cilat jane duke u zhvilluar punimet, me keto zbrazetira per instalime mund te hyjne shiu dhe bora, dhe parkingu te mbetet i papastruar te

na tregoni se kush e pastron ne kete rast me qenese parkingu mund te mbetet jo funksionale pasi qe kompania kontraktuese eshte duke punuar. Te tregoni ne paramase sa here duhet te pastrohet dhe kush merr pergjegjesi per pastrim pasiqe parkingu mund te jete i papaster nga kompania pune kryese.

3. Kerkesa 3. Keni kerkuar Menaxhim i veturave ne parking Ju lutem te tregoni ne paramase se si duhet te behet menaxhimi i veturave, kur parkingu nuk posedon as LAURA per hyrje dhe dalje. Cfare menaxhimi keni planifikuar ? Kerkesa 4 ju keni kerkuar: Automjeti nuk mund te qendroj me shume se 24 ne parking, ne rast se nje automjet qendron me shume se 24 ore ne parking, kompania ka te obligim te largon automjetin nga parkingu dhe ta barte deri ne parking të vet. Ju keni kerkuar largim te automjeteve mbrenda parkingut e cila eshte e pamundur per arsye se parkingu ka nje hapsire te paster per mbrenda me lartesi 2.70 meter, ndersa kerkoni te largoni mjetin i cili eshte i parkuar ne parking me shume se 24 ore. Si mund te largohet nje automjete kur nuk ka hapsire per ngritje te automjetit per te vendosur ne AUTOMJET per bartje te makinave. ? Te tregohet pozicioni se cfare duhet te beje kompania kontraktuese pasi qe automjeti nuk mund te largohet sepse nuk ka hapsire per ngritje. A eshte ky specifikacion per te arsyetuar korrupsionin e juaj per zhvatje te 80,000.00 euro per mbrenda nje viti apo pse pasqyrohet kjo kerkese. Perveq kesaj, asnje kompani kontraktuese nuk ka te drejt te konfiskoon apo te largon asnje mjete te askujt por duhet te lajmerohet organi kompentent POLICIA E KOSOVES, se bashku me menaxherin e kontrates dhe te largon policia e kosoves e jo kompania pune kryese, Ne kerkojme te rregullohet ky pozicion ne paramase dhe jo te krijohet hamendje me keto kerkese ne menyre se kinse kane per tu kryer dhe kjo paraqet vjedhje flagrante te parase publike. Te kerkesa nr 5 Mirembajtja e ëc-se. Parkingu ende nuk posedon EC, ju lutem te tregohet se cilat EC duhet te mirembahen, Kjo paraqet joseriozitet nga ana e juaja duke pershkruar pune te cilat kinse kane per tu kryer dhe nuk mund te kryhet asnje nga kerkesat e juaja, ndersa ne paramase keni kerkuar pozicion te mirembajtjes per cdo muaj. Kjo paraqet tentim per vjedhje te 80,000.00 euro per mbrenda nje viti ndersa parkingu eshte ende jo funksional. Te tregohet ne paramase se si duhet te behet mirembajtja e EC-se. Per cdo pozicion ?
4. Te kerkesa nr 6 ju keni kerkuar Kompania kontraktuese duhet te paraqese nje deklarate se qfare shume do te zbatohet ne rastin e terheqjes apo largimit te automjeti nga parking, deri në parkingun e OE, max 30€. Ju keni parashtruar kerkese e cila nuk mund te realizohet, sepse automjeti nuk mund te largohet per mbrenda parkingut sepse parkingu ka nje hapsire te mbrendshme me lartesi 2.70m dhe eshte e pamundur te largohet automjeti, por edhe te largohet automjeti asnje kompani private nuk ka te drejt te largon mjetin e askujt perveq policise se kosoves, dhe policia e kosoves e deponon automjetin ne vendin e tyre dhe jo ne depo private. Ne kerkojme qe ky pozicion te korigjohet ne paramase dhe te tregohet se si duhet te veproje kompania kontraktuese ne kete rast. Kjo eshte nje paraqitje e juaja qe tentoni zhvatjen e 80,000.00 euro me keto pershkrime. Me kete pershkrim zyrtari pergjegjes i prokurimit tenton te zhvillon nje procedure korruptive per punet e padefinuar te cilat kane per tu kryer ne vlere prej 80,000.00 euro, me kete rast do te njoftohet Agjencioni per parandalimin e korrupsionit si dhe KRPP se si zhvillohet nje procedure per mirembajtje per nje projekt te cilen nuk ka perfunduar ende. Ne dosje te tenderit keni kerkuar : Kerkesa 4. OE duhet te perket një parking per vetura jo më larg se 10 km nga parakingu i Komunes. Pse eshte i nevojshem ky parking, kur kjo eshte kompetence e policise se kosoves ? Per cilen kompani te favorizuar e keni drejtuar kete procedure te prokurimit ? Kerkesa 2. Lista e pajisjeve a. Automjet per barjten te makinave min 1 copë, b. Makine per pastrimin e dyshemese min 2 copa. Per cfare eshte i nevojshem automjeti per bartje te makinave kur nuk mund te largohesh automjetin nga parkingu sepse nuk ka hapsire per ngritje te automjetit sepse parkingu ka hapsire 2.7 m, dhe kete pune e kryen policia e kosoves. Kjo kerkese eshte e panevojshme dhe duhet te largohet.
5. Kerkesa 2. Lista e pajisjeve a. Automjet per barjten te makinave min 1 copë, b. Makine per pastrimin e dyshemese min 2 copa. Ju keni kerkuar MAKINE PER PASTRIM TE DYSHEMES. Te tregoni qfare makine eshte, a eshte fshise e rrymes a po cfare makine. Keto kerkese se bashku me paramasen jane kontradiktore me gjendjen faktike dhe punet te cilat

kane per tu kryer kerkojme nga ju te ndaleni vjedhjen e 80,000.00 euro ne kete procedure te korigjohet paramasa per punet te cilat kane per tu kryer dhe kerkesat e ne dosje te tenderit


Përgjigjeje:

Autoriteti kontraktues do të bëjë përmirësimin e Dosjes së Tenderit të Specifikacioni teknik, dhe në të njejtën kohë do ta shtyje afatin e dorëzimit të ofertave.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtör i Prokurimit